



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 24.02.2025 ora 14:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli
Znj. Irena Shala
Znj. Valjeta Bajraktari
Z. Gjergj Sokoli

Mungon:

Z. Blendi Gjylbegaj
Z. Edmond Ndou
Znj. Violeta Perndrecaj

Vijohet me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Diskutohet mbi pikat e parashikuara të rendit të ditës, për të cilat nuk ka asnjë paqartësi dhe të gjithë anëtarët e kryesisë shprehin dakordësinë e tyre për kalimin e tyre për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Znj. Shala pyet nëse bëhet fjalë për pronë private apo publike në lidhje me pr/vendimin: "*Përditësim të VKK Bërdicë nr. 29, datë 06.05.2008 " Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë "* të miratuar me VKM nr.895, datë 10.11.2010, "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës "*, dhe inventarizimin e pasurisë me nr.383 volum 1, faqe 207 ZK 1157.

Sqaron Z.Preka që bëhet fjalë për inventarizimin e një prone shtetërore. Ai gjithashtu bën një prezantim të këtij projekt akti.

Z.Luli propozon datën 03.03.2025 për zhvillimin e mbledhjen. Të gjithë shprehin dakordësi. Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka .

Mbledhja e rradhës së Këshillit Bashkiak do të mbahet ditën e Hënë datë 03.03.2025 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

1. *Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2025".*

2. *Pr/ Vendim: "Për strehimin emergjent të Znj.G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish –Konvikti i Shkollës veterinare).*
3. *Pr/ Vendim: "Përditësim të VKK Bërdicë nr. 29, datë 06.05.2008 " Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë" të miratuar me VKM nr.895, datë 10.11.2010, " Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës", dhe inventarizimin e pasurisë me nr.383 volum 1, faqe 207 ZK 1157.*
4. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e Kërkesës të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr.2/204, nr.2/699, ZK 8593, pasurive me nr.3/733 dhe nr.3/957 ZK 8591".*
5. *Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencive funerale/shtëpi funerale (Salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër".*
6. *Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër", të ndryshuar.*
7. *Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024.*
8. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



SEKRETAR

Sabina DANAJ

